



Grupi punues për Kinematografi

Propozim për shpalljen e Filmit Interes i Veçantë Shtetëror

Drejtuar: Ministrinë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Datë: 26 tetor 2021, Prishtinë

HYRJE

Në 10 vitet e fundit kinematografia kosovare ka pasur zhvillim të jashtëzakonshëm. Përkundër buxhetit tejet të ulët, pjesëmarrja e filmave kosovar në festivalet e kategorisë A ka tejkaluar të gjitha shtetet në rajon. Vetëm këtë vit filmi 'Zgjoi' nga Blerta Basholli ka fituar tri çmimet kryesore në Sundance; 'Në kërkim të Venerës' nga Norika Sefa ka fituar çmimin special të Jurisë në Rotterdam; 'Pa vend' nga Samir Karahoda dhe 'Luaneshat e Kodrës' nga Luana Bajrami u shfaqën në Festivalin e Kanës; ndërsa Vera Andrron Detin nga Kaltrina Krasniqi u shfaq në Festivalin e Venedikut.

Sukseset e viteve të mëparshme të filmave kosovar dhe të bashkëprodhuar me Kosovën përfshijnë: filmin e shkurtër 'Shok' i cili ishte i nominuar për Oscar, filmi i shkurtër 'Home' i cili fitoi çmimin Bafta; dhe sukcesi ndërkombëtar i filmave të tillë si 'Shpia e Agës' nga Lendita Zeqiraj, 'Zana' nga Antoneta Kastrati, 'Babai' dhe 'Exil' nga Visar Morina, 'Nëntor i Ftohtë' nga Ismet Sijarina, 'Tri dritare dhe një varje' nga Isa Qosja, 'Cirku Fluturues' nga Fatos Berisha etj. Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se filmat e prodhuar me Kosovën, të tillë si 'Burrneshat' nga Laura Bispuri, 'Bota' nga Iris Elezi, dhe 'Delegacioni' nga Bujar Alimani kishin gjithashtu sukseste të rëndësishme ndërkombëtare.

Filmat kosovarë janë shfaqur dhe kanë fituar çmime në festivalet të rëndësishme si në: Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Berlin, Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Venedik, Festivalin e Karlovy Varit, Festivalin e Filmit Sundance, Festivalin e Filmit në Toronto, Festivalin e Filmit në Jerusalem, Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Palm Springs, Festivalin e Filmit në Sarajevë, Festivalin e Filmit në Selanik etj.

Pjesëmarrja e shpeshtë në festivale ndërkombëtare ka përfaqësuar Kosovën duke u shëndrruar natyrshëm në një mjet dhe mënyrë të sofistikuar të të bërit diplomaci kulturore. Përderisa në vend, festivalet si DokuFesti në Prizren, Prifesti në Prishtinë, dhe festivali i filmit të animuar - Anibar në Pejë, vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe promovimin e industrisë filmike dhe filmave vendor.

Ky dokument përshkruan në vija të trasha hapat e nevojshëm që duhen ndërmarrë nga qeveria dhe institucionet për ta bërë kinematografinë fushë me interes të veçantë shtetëror. Këto hapa janë të kategorizuar në katër nivele siç vijojnë më poshtë.

VEPRIMET E PROPOZUARA

1. Korniza ligjore

Ligji që është aktualisht në fuqi është i kohës së UNIMIK-ut dhe përveç që nuk reflekton me zhvillimet e reja të fushës, ai përmban edhe paqartësi e kundërthënie, posaçërisht në raport me të drejtat autoriale dhe ligjin e mëvonshëm për subvencione. Drafti aktual i ligjit i ri për kinematografi i cili është duke u përpiluar në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin filmbërës reflekton nevojat dhe domsdoshmëritë bashkëkohore për krijimin e kushteve për një zhvillim të tillë.

Është jetike që ligji i ri, dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë fushën e kinematografisë, të integrojnë aspektet e propozuara në këtë draft-ligj sikur: rabatin, lehtësirat financiare, kthimin e kinemave që janë nën menaxhim të AKP-së në prona publike dhe shpallja e tyre si interes i veçantë publik.

Poashtu, ligji për sponsorim diskriminon kulturën, në këtë rast edhe filmin, të dyja këto edhe ashtu të diskriminuara. Amandamentimi i ligjit për sponsorim në drejtim të bërjes më tërheqëse sponsorimin e Kulturës, do ta rriste potencialin dhe do të krijonte një mundësi alternative dhe reale për mbështetjen e filmit.

2. Mbështetja financiare

Sukseset e vazhdueshme ndërkombëtare të filmave kosovar viteve të fundit nuk reflektuan me mbështetjen mjaftueshme institucionale e financiare. Për ta plotësuar këtë mbështetje të pamjaftueshme në vitet e fundit, mirëpo edhe më me rëndësi, për ta reflektuar, mirëmbajtur dhe rritur këtë sukses të kinematografisë, zhvilluar industrinë filmike, hapur vende të reja të punës, prurje të investimeve nga jashtë, ngritjen e kapaciteteve profesionale tek të rinjtë, dhe integruar filmin dhe artet tjera dramatike në edukim, është më se e nevojshme rritja substanciale dhe eksponenciale e buxhetit.

Viteve të fundit, shtetet fqinje kanë ndarë buxhete që variojnë nga 4 deri 12 fish të buxhetit që ndan Kosova. Gjatë qeverisje së kaluar, Maqedonia Veriore, një shtet me demografi dhe me nivel të prodhimtarisë kinematografike të ngjashme me Kosovën, ka ndarë deri në 7 milion euro në vit për Agjensionin e saj të Filmit.

3. Infrastruktura fizike

Është me interes strategjik kthimi i kinemave që kanë qenë prona shoqërore në prona publike dhe shpallja e tyre interes i veçantë publik duke u siguruar që këto kinema do të shërbejnë për shfaqjen e veprave artistike audio-vizuele dhe si hapësira për aktivitete të tjera nga fusha e kinematografisë dhe kulturës.

QKK-ja dhe Kosovafilm-i duhet të kenë objektet e veta (të përbashkëta apo të ndara), në të cilin përfshihen sallat e shfaqjes, galeria, libraria, kinoteka, hapësira për arkivimin e materialeve filmike dhe audio-vizuele, studiot dhe hapësirat e punës që reflektojnë kapacitetin e ardhshëm njerëzor të këtyre institucioneve.

4. Burimet njerëzore

Një zhvillim i tillë duhet të realizohet paralelisht me rritjen e kapaciteteve profesionale dhe institucionale. Kjo së pari implikon rritje të kapaciteteve njerëzore në Qendrën Kinematografike të Kosovës dhe Kosovafilm-in duke përfshirë krijimin dhe rritjen e kapaciteteve të njësive të dedikuara sikur: Kosova Film Promotion, Edukimi për Filmin dhe Edukimin përmes Filmit, Shtimin e funksioneve profesionale e artistike, këshilluese, hartuese, hulumtuese, por edhe ndërlidhëse me institucionet tjera (p.sh. për arritjen e potencialit të filmit për diplomaci kulturore), si dhe rritjen e domosdoshme të kapaciteteve të stafit administrativ financiar, ligjor dhe koordinues.

Me këtë rritje të përgjithshme në fushën e kinematografisë është i domosdoshëm zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve të ekspertëve njohës së legjislaturave vendore dhe ndërkombëtare të fushës së kinematografisë dhe drejtës se autorit në gjykatat e vendit.

Për të siguruar mbarëvajtje të proceseve drejt bërjes së filmit interes i veçantë i shtetëror është i nevojshëm krijimi i këshillit shtetëror mbikqyrës të implementimit.

Anëtarët e Grupit Punues



Lum Çitaku (QKK)




Ilir Gjocaj (KosovaFilm)



Fatos Berisha (PriFest)



Fatmir Spahiu (Aktor/Producent)



Veton Nurkollari (DokuFest)



Yll Uka (Shoqata e Producentëve)



Kaltrina Krasniqi (Shoqata e Producentëve)